



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-108

**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS NR. 03/L-046,
TË DATËS 15.06.2008**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS NR.
03/L-046, TË DATËS 15.06.2008**

Neni 1

Pika a) e nenit 8 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës ndryshohet si vijon:

a) “Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës emërohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe mund të ndërrohet në pajtim me nenin 94 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Zëvendës Ministri[at] emërohen sipas ligjit në fuqi.”

Neni 2

Pas nenit 18 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, shtohet një nen i ri 18. A.

**“Neni 18.A
Dispozita kalimtare**

Ministri dhe Zëvendës Ministri(rat) i/e parë i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës emërohet nga Kryeministri pas miratimit të Ligjit për Ministrinë e FSK Nr. 03/L-045 të datës 15.06.2008 dhe Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr. 03/L-046 të datës 15.06.2008 siç janë ndryshuar më pas. ”

Neni 3

Ky Ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-108
10 nëntor 2008**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI